



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 02 shtator 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1401_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 par. 1 nënparagrafi 1.11, Nenit 4, Nenit 6, Nenit 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 dhe Nenit 19 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Kapitullit VI të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës **12.11.2020** për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja **"GSA ENERGJI" SH.P.K.**, adresa: Xheladin Hana, Obj.35/15, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 02 shtator 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. I VAZHDOHET Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes "GSA ENERGJI" SH.P.K tani me numër licence ZRRE/Li_51/17 për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 02 Shtator 2021 deri 01 shtator 2026.**
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për "GSA ENERGJI" SH.P.K. të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.**

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 12.11.2020 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike nga përfaqësues të ndërmarrjes **"GSA ENERGJI" SH.P.K.**
- Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duhet dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **"GSA ENERGJI" SH.P.K.** me datë 07 dhjetor 2020 ka njoftuar përmes gazetave palët e interesit se ka dorëzuar aplikacionin në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.



- Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
 - Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar. Në këtë rast Rregullatori i është pamundësuar të veproj në pajtim me Nenin 7 të kesaj rregulle, në mungesë të kuorumit të Bordit, pasi që Neni 25, paragrafi 2 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë parasheh se, citoj: *"Kuorumi për seancat e Bordit është tre (3) anëtarë. Seancat e Bordit mbahen nëse ekziston kuorumi..."*. Kuorumi i Bordit është bërë nga data 02.08.2021.
 - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas udhëzimeve të rregullatorit, aplikacioni është konsideruar i kompletuar, kështu që Bordi i Rregullatorit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - Licenca e lëshuar me datë 19.05.2016 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_51/16), e modifikuar me 10.05.2017 (Nr. i licencës ZRRE/Li_51/17) vazhdohet me licenën e lëshuar me datë 02 shtator 2021 dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 15 të Licencës së lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi. Të gjitha dispozitat e licencës së lëshuar me datë 19.05.2016 mbulohen me licencën në fuqi.
- III. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.



Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit **GSA ENERGJI SH.P.K.**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtar

Gani Buçaj, Anëtar